

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8006
E enjte, 6 mars 2025
Çmimi 0.50

Refuzimi i dëshmimit në
prokurori nga kryeministri
Kurti është përpjekje për
pengim të drejtësisë kundër
korrupsionit I FAQE 5

Shkruan:
Hajdin ABAZI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

27 VJET NGA EPOPEJA E UÇK-së, KOSOVA PO FUQIZON USHTRINË

I FAQE 4-5



Në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë të mërkurën është mbajtur një ceremoni për ta përkujtuar 27-vjetorin e Epopesë së UÇK-së dhe për ta nderuar kujtimin e komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe

të gjithë dëshmorëve të kombit që ranë për liri. Përfaqësuesit e shtetit në fjalimet e tyre thanë se që nga çlirimi i atdheut në qershor 1999 dhe deri më sot e tutje, një nga detyrat kyçe për ruajtjen e lirisë së fituar me gjakun

e dëshmorëve dhe martirëve të popullit tonë ka qenë dhe vazhdon të mbetet fuqizimi i ushtrisë së Kosovës. Gjithashtu, në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz janë bërë homazhe

**VOTAT ME KUSHT
NUK E NDRYSHOJNË
REZULTATIN,
LV-JA 48 MANDATE,
PDK-JA 24, LDK-JA
20 DHE AAK-NISMA 8**

F. 6



**KËSHILLI I
EVROPËS HEQ
NGA RENDI I
DITËS KËRKESËN
E KOSOVËS PËR
STATUSIN E
MYSAFIRIT
SPECIAL F. 3**



**96.7 % E EKONOMIVE FAMILJARE
KANË NË PRONËSI ME AKT LIGJOR
SHTËPITË/BANESAT F. 8**

**SHQIPTARËT, MË PAK TË PAGUARIT
PËR ORË NË EVROPË F. 8**

SPORT



**PORTIERJA AURORA KRYEZIU
TRANSFEROHET TE MAINZI F. 6**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shagiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

A mund Evropa ta armatosë Ukrainën?

KIEV, 5 MARS - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka urdhëruar ndërprerjen e ndihmave ushtarake për Ukrainën. Administrata Trump tha se kishte për qëllim të detyronte të gjitha palët të përkushtoheshin në bisedimet për paqe. Udhëheqësit evropianë kanë thënë se është jetike të vazhdohet me dërgesat e armëve në Kiev. Megjithatë, nuk është e qartë se për sa kohë Ukraina mund të vazhdojë të rezistojë pa ndihma. Ndërsa doli lajmi për vendimin e Uashingtonit për ndërprerjen e ndihmave ushtarake për Kievin, sulmet ruse me dronë vazhduan mbi qytetet ukrainase. Ligjvënësit ukrainas thonë se pasojat e vendimit të Uashingtonit do të jenë të rënda. “Kjo do të thotë se mijëra njerëz do të vdesin”, thotë Oleksiy Goncharenko deputet ukrainas. Në përfundim të Donetskut, afër qytetit Pokrovsk, lufta vazhdon. “Ne përdorim një top artilerie ‘Howitzer’ italian. Megjithatë, shumë municione i marrim nga Shtetet e Bashkuara. Është

standard i NATO-s, i cili përdoret si në Evropë ashtu dhe në Amerikë. Por, a do të jetë tani në gjendje Evropa të na furnizojë, shpresoj se po”, thotë komandanti i njësisë së brigadës së 14-të ukrainase që përdor nofken “Berf”. A mund të kompensojë Evropa mungesën e ndihmës ushtarake nga Shtetet e Bashkuara? “Ka sisteme të caktuara, si raketat ‘Patriot’, apo pjesët rezervë për tanket ‘Abrams’ që përdoren nga ukrainasit. E vetmja mënyrë që evropianët t’i sigurojnë ato është blerja në tregun e hapur. Kjo kërkon kohë”, thotë Mark Galeotti, ekspert për Rusinë nga firma ‘Mayak Intelligence’. Megjithatë, Ukraina po prodhon gjithnjë e më shumë armë. “Ndoshta rreth gjysmën e armëve që përdor tani, Ukraina i prodhon vetë. Pjesa tjetër sigurohet nga Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera, përfshirë evropianët”, thotë Malcolm Chalmers nga organizata “Royal United Services Institute”. Uashingtoni ofron ndihmë jetike,



si transportimin e armëve perëndimore në Ukrainë. “Shtetet e Bashkuara luajnë rol shumë të rëndësishëm duke ofruar informacion dhe të dhëna të inteligjencës për forcat ukrainase”, thotë analisti Chalmers. Administrata Trump thotë se ndalimi i ndihmave ushtarake është bërë, siç sqarojnë zyrtarët amerikanë, “për të ndihmuar në arritjen e një zgjidhjeje”. “Shtetet e Bashkuara, Evropa dhe po ashtu Ukraina nuk mund ta vazhdojnë

këtë luftë pa fund. Prandaj, është e rëndësishme që të gjithë të marrin pjesë në negociatë”, thotë JD Vance, nënpresident i Shteteve të Bashkuara. Kryeministri britanik Keir Starmer tha gjatë fundjavës se ekziston një koalicion i vendeve që duan të vazhdojnë mbështetjen për Ukrainën. “Pretendimi i Nënpresidentit Vance se shumë nga udhëheqësit evropianë i ofrojnë mbështetje Kievit publikisht, ndërsa privatisht

shprehen me skepticizëm, nuk është në tërësi i pasaktë. Pyetja në këtë rast është, a do të vazhdonin këto vende të boshatisnin rezervat e tyre ushtarake dhe të zemëronin aleatin dhe garantuesin kryesor të sigurisë së vendit të tyre për të vazhduar mbështetjen për Ukrainën?”, thotë eksperti për Rusinë, Mark Galeotti. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky njoftoi administratën Trump të martën, përmes një publikimi në rrjetin social ‘X’, se Ukraina është e përkushtuar për paqe. Për ukrainasit, që vuajnë nga sulmet ajrore ruse, ndërprerja e ndihmës amerikane është një rezultat i hidhur. “Shpresoj që presidenti Trump të ndryshojë mendjen. Viktima e agresionit nuk mund të jetë fajtorë dhe të ndëshkohen”, thotë Viktoria, banore e Kievit. Ndërkaq, Rusia e mirëpriti vendimin e Uashingtonit për ndalimin e ndihmave ushtarake për Ukrainën duke thënë se “situata duhet zgjidhur me mjete paqësore”.

ShBA-ja pezullon ndarjen e informatave të inteligjencës me Ukrainën

UASHINGTON, 5 MARS - Shtetet e Bashkuara kanë “pezulluar” ndarjen e informatave të inteligjencës me Ukrainën, tha drejtori i Agjencisë Qendrore amerikane të Inteligjencës (CIA), John Ratcliffe. Njoftimi vjen pas përkeqësimit dramatik të raporteve mes Kievit dhe Uashingtonit. Presidenti amerikan, Donald Trump, dhe ai ukrainas, Volodymyr Zelensky, u përplasën në Zyrën Ovale javën e kaluar dhe pas kësaj, ShBA-ja njoftoi se ka pezulluar ndihmën thelbësore ushtarake për Ukrainën. Ratcliffe konfirmoi se ndarja e



inteligjencës është ngrirë, teksa Ukraina po vazhdon të luftojë kundër pushtimit që

Rusia ka nisur më 2022. “Presidenti Trump kishte një pyetje të vërtetë nëse

presidenti Zelensky ishte i angazhuar për procesin e paqes”, tha Ratcliffe për Fox News. Ratcliffe tha se pezullimi “në frontin ushtarak dhe në frontin e inteligjencës” është i përkohshëm dhe ShBA-ja do të punojë sërish “krah për krah me Ukrainën”. Të martën, Trump deklaroi se Zelensky i tha se Kievi ishte i gatshëm për bisedime me Moskën dhe për finalizimin e marrëveshjes për minerale me ShBA-në, teksa Ukraina po tenton që të tejkalojë përplasjen në Zyrën Ovale. Zelensky ka tentuar që të

përmirësojë raportin me Trumpin, duke shkruar në rrjetet sociale se ishte për “keqardhje” përplasja e tij me udhëheqësin amerikan e duke shtuar se dëshiron që të përmirësojë situatën. Në adresimin e tij në Kongresin amerikan të martën, Trump e lexoi letrën e Zelenskyt. “Në letrë thuhet ‘Ukraina është e gatshme të vijë në tavolinën e negociatave sa më shpejt që të jetë e mundur për të sjellë më afër paqen e qëndrueshme. Askush nuk e do më shumë paqen sesa ukrainasit’”, tha Trump para ligjvënësve amerikanë.

Zelensky thotë se përplasja e tij me Trumpin ishte për “keqardhje”

KIEV, 5 MARS - Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka thënë se përplasja e tij me presidentin amerikan, Donald Trump, ka qenë për “keqardhje” dhe që është gati të punojë me homologun e tij amerikan për të arritur paqe afatgjatë, dhe që është koha për t’i bërë gjërat “siç duhet”. “Takimi ynë në Uashington, në Shtëpinë e Bardhë, të premten, nuk ka shkuar siç ishte planifikuar. Është për keqardhje që u zhvillua ashtu. Është koha t’i bëjmë gjërat siç duhet. Ne do të dëshironim bashkëpunim të mëtejshëm dhe komunikim konstruktiv”, ka thënë lideri ukrainas përmes një postimi në “X”. Këto janë deklaratat e para të

Zelenskyt pas pezullimit të ndihmës ushtarake amerikane për Ukrainën. “Ne e vlerësojmë shumë sa shumë ka bërë Amerika për t’i ndihmuar Ukrainës për të ruajtur sovranitetin dhe pavarësinë”, ka shkruar Zelensky, duke shtuar se: “Ne e kujtojmë kohën kur gjërat kanë ndryshuar, pasi presidenti Trump na ka dhënë raketat Javelin. Jemi mirënjohës”. Zelensky ka thënë se është i gatshëm të nënshkruajë marrëveshjen për mineralet e rralla, të cilën administrata Trump e konsideron shumë të rëndësishme në përpjekjet për dhënie fund të luftës. “Sa i përket marrëveshjes për minerale dhe siguri, Ukraina

është e gatshme ta nënshkruajë atë në çdo kohë dhe format të përshtatshëm. Ne e shohim këtë marrëveshje si hap drejt garancive më të mëdha dhe garancive solide të sigurisë, dhe unë njëmend shpresoj që do të funksionojë”, ka thënë Zelensky. Presidenti ukrainas ka thënë se është i gatshëm për “armëpushim në qiell - ndalesë në raketa, dronë me rreze të gjatë, bomba në sektorin e energjisë dhe infrastrukturën tjetër civile - dhe armëpushim të menjëhershëm në det, nëse edhe Rusia vepron njëjtë”. Zelensky ka diskutuar me tone të ashpra me Trumpin dhe nënpresidentin amerikan JD Vance, lidhur me qëndrimin e



Uashingtonit për luftën, dhe situata është përshkallëzuar sikur asnjëherë më parë. Ky takim është zhvilluar disa javë pasi Trump e ka quajtur

homologun ukrainas “diktator”, derisa Zelensky ka thënë se presidenti republikan është i rrethuar nga dezinformatat ruse.

VOTAT ME KUSHT NUK E NDRYSHOJNË REZULTATIN, LV-ja 48 MANDATE, PDK-JA 24, LDK-JA 20 DHE AAK-NISMA 8

EPOKA ERE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është drejt përfundimit të numërimit të votave me kusht nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë. Sipas përditësimit të fundit në uebfaqen e KQZ-së të mërkurë në orët e hershme, janë numëruar rreth 80 për qind e votave me kusht. Lëvizja Vetëvendosje i ka fituar 40.21 për qind, apo 2 634 vota me kusht. E dyta është Partia Demokratike e Kosovës me 18.11 për qind, apo 1 186 vota, pastaj vijjnë Lidhja Demokratike e Kosovës me 13.54 për qind, apo 887 vota, Lista Serbe me 11.37 për qind, apo 745 vota, si dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma me 6.21 për qind, apo 407 vota. Numërimi i votave me kusht dhe i personave me aftësi të kufizuara nisi këtë të martë, në ditën kur përfundoi numërimi i votave me postë. Zyrtarë të KQZ-së kanë thënë se procesi i numërimit të votave pritet të përfundojë më 5 mars. Me rezultatet e tanishme, që përfshijnë edhe votat në vendvotimet në Kosovë, ato në përfaqësitë diplomatike dhe me postë, asnjëra parti nuk ka siguruar numër të

mjaftueshëm për të qeverisur e vetme. Për ta pasur shumicën, duhen së paku 61 deputetë në Kuvendin me 120 ulëse të Kosovës. Si partia e parë, Vetëvendosje i ka aktualisht 48 deputetë. Udhëheqësi i saj, kryeministri Albin Kurti, është zotuar se do ta formojë qeverinë në mënyrë të pavarur. Partitë aktualisht në opozitë, përveç Nismës, e kanë përjashtuar mundësinë e koalicionit me të. Procesi i numërimit të votave është aktualisht në javën e katërt. KQZ-ja pritet ta bëjë certifikimin e rezultateve në mes të këtij muaji. Analistët thonë se ka disa opsione të mundshme për formimin e qeverisë së re. Analisti Shenoll Muharremi ka komentuar rezultatet e fundit të votave në Kosovë, nga diaspora dhe atyre me kusht. Ai ka thënë se LV-ja do të ketë 48 mandate, PDK-ja 24, LDK-ja 20 dhe AAK-Nisma 8 mandate. “Aktualisht, kjo është gjendja e integruar gjithëpërfshirëse sa i përket votave nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Këtu kemi Votat në Kosovë (100%, Votat e Diasporës (100%) dhe Votat me Kusht (44 nga 56 kuti). Rezultatet Aktuale/Mandatet: LVV: 392,618 vota / 48 mandate. PDK: 194,541 vota / 24 mandate. LDK: 170,024 vota /



20 mandate. AAK-Nisma: 65,741 vota / 8 mandate. Pakicat/tjerat: 106,179 vota / 20 mandate pakicat. Gjithsejtë: 929,103 vota / 120 mandate. Ende prite të numërohen edhe 12 nga 56 kuti të votave me kusht dhe pastaj votat e personave me nevoja të veçanta. Nuk pritet të ketë ndikim të theksuar në rezultate dhe mandate”, ka shkruar ai në “Facebook”.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka urdhëruar që të rinumërohen të gjitha qendrat e vendvotimeve në komunën e Vushtrrisë. Ky vendim i Prokurorisë vjen pasi kandidatja për deputete nga LDK-ja, Rrezarta Krasniqi ka akuzuar se ka pasur keqpërdorimin e votave në disa qendra. Sipas vendimit të Prokurorisë, thuhet se ekziston dyshimi se

ka pasur manipulim të vota për ta ndihmuar kandidatin tjetër të LDK-së, Xhafer Tahiri. “Të bëhet rinumërimi i votave që kanë rezultuar nga të gjitha qendrat e vendvotimeve në komunën e Vushtrrisë dhe atë rinumërimit për kandidatët të Kuvendit të Republikës së Kosovës në zgjedhjet parlamentare të Kosovës të organizuar më 9 shkurt”, thuhet në vendimin e prokurorisë.

Këshilli i Evropës heq nga rendi i ditës kërkesën e Kosovës për statusin e mysafirit special

PRISHTINË, 5 MARS - Kërkesa e Kosovës për të qenë mysafire speciale në Komitetin për Çështje Politike dhe Demokraci të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës u hoq nga rendi i ditës, konfirmoi delegacioni i Kosovës pranë KIE-së. Kjo kërkesë ishte në rendin e ditës së takimit të Komitetit, i cili po mbahet në Paris. Ariana Musliu Shoshi - pjesë e delegacionit të Kosovës - tha se me kërkesë të kryetarit të Grupit të Partisë Popullore Evropiane, Pablo Hispan, u votua për shtyrjen e kësaj pike nga rendi i ditës. Musliu Shoshi e cilësoi këtë si “një zhvillim të papritur”. “Kjo situatë tregon nevojën për mobilizim si shtet, në bashkëpunim me aleatët tanë, për të krijuar një strategji të qartë që do të sigurojë realizimin e prioriteteve dhe agjendave tona në arenën ndërkombëtare”, shkroi ajo në Facebook. Më herët për një gjë të tillë raportoi edhe kryetarja e Kuvendit të Serbisë, Ana Bërnabiq. Gjatë seancës së Kuvendit të Serbisë, ajo tha se është njoftuar nga shefja e




delegacionit serb në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Bilana Pantiq. “Mirënjohje e madhe për miqtë tanë nga Spanja, mirënjohje e madhe për miqtë tanë nga Partia Popullore Evropiane (EPP), të cilët na ofruan mbështetje në

mënyrë që ta kishim shumicën për të arritur ta heqim këtë pikë nga rendi i ditës i Komitetit politik të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës”, tha Bërnabiq. Të pranishëm në takim ishin edhe Besnik Tahiri dhe Ariana

Musliu Shoshi, anëtarë të delegacionit të Kosovës pranë Këshillit të Evropës. Radio Evropa e Lirë ka bërë përpjekje t'i kontaktojë ata për një koment. Gjithashtu, “Radio Evropa e Lirë” i është drejtuar edhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës për

këtë çështje. Asambleja Parlamentare mund t’u japë statusin e mysafirit të veçantë parlamenteve kombëtare të vendeve evropiane që nuk janë shtete anëtare, por të cilat kanë aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Anëtarët e delegacionit të mysafirit special mund të ulen në Asamblenë Parlamentare, por nuk kanë të drejtë vote. Ata kanë të drejtë të mbajnë fjalim me leje të presidentit të Asamblesë. Kosova dështoi të anëtarësohet në Këshillin e Evropës në fillim të vitit 2024 për shkak se u kushtëzua me krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Vitin e kaluar Serbia kishte formuar grup punues për koordinimin e aktiviteteve të autoriteteve shtetërore kundër pranimi të Kosovës në Këshillin e Evropës. Këshilli i Evropës është organizatë lidere për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Anëtarësimi eventual do t’i ndihmonte Kosovës, mes të tjerash, në fushën e sundimit të ligjit dhe luftimin e korrupsionit.



27 VJET NGA EPOPEJA E UÇK-së, KOSOVA PO FUQIZON USHTRINË

Në Kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë të mërkurën është mbajtur një ceremoni për ta përkujtuar 27-vjetorin e Epopesë së UÇK-së dhe për ta nderuar kujtimin e komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit që ranë për liri. Përfaqësuesit e shtetit në fjalimet e tyre thanë se që nga çlirimi i atdheut në qershor 1999 dhe deri më sot e tutje, një nga detyrat kyçe për ruajtjen e lirisë së fituar me gjakun e dëshmorëve dhe martirëve të popullit tonë ka qenë dhe vazhdon të mbetet fuqizimi i ushtrisë së Kosovës. Gjithashtu, në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz janë bërë homazhe

Kosovës. “Ishin shembulli më i mirë sesi duhet vendi e si duhet liria. Hamëz Jashari bashkë me Adem Jasharin dhe të gjithë familjen e tyre qëndruan të palëkundur në luftë duke dëshmuar se s’ka sakrificë më të madhe sesa flijimi për të ardhmen dhe flijimi për atdheun. Ato tri ditë të marsit, 5, 6 dhe 7 mars të 1998-s në Prekaz, ndodhi një ndër betejat më heroike të kombit shqiptar. Dëshmorë, përveç burrave, u bënë edhe fëmijët, gratë dhe pleqtë. Prekazi nuk ishte vetëm një fshat, por ishte një kështjellë e lirisë. Ishte një fortifikatë e pamposhtur e kombit tonë dhe i tillë mbetet edhe sot. Familja

Jashari është themeli mbi të cilën është ngritur liria e Kosovës”, ka thënë Osmani. Osmani shtoi se Epopeja e UÇK-së na ka mësuar se asgjë nuk është e pamundur kur ka guxim për të qëndruar të bashkuar për idealin e lirisë. Prandaj, ajo theksoi se sot më shumë se kurrë duhet përbashkuar për ta mbrojtur vendin. “Kjo ushtri me profesionalizëm dhe përkushtim është gjithmonë e gatshme t’i dalë zot vendit. FSK-ja, ashtu sikurse Policia e Kosovës, janë garanci për sovranitetin tonë. Një mburojë për paqen dhe sigurinë e qytetarëve tanë dhe një dëshmi se sakrifica e dëshmorëve të kombit nuk ka qenë e kotë. Epopeja e UÇK-së na mësoi se asgjë nuk është e pamundur kur kemi guximin për të qëndruar të bashkuar për idealin e lirisë. Prandaj sot më shumë se kurrë duhet të qëndrojmë të bashkuar për ta mbrojtur Kosovën tonë. Për ta bërë atë më të fortë dhe dinjitoze dhe respektuar në botë. Le të ecim përpara me guxim dhe krenari për t’i treguar botës se Kosova është dhe do të mbetet një vend suksesi”, ka deklaruar Osmani. Në kuadër të programit të manifestimit shtetëror për shënimin e 27-vjetorit të

**EPOKA
ERE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 5 MARS - Në Kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë të mërkurën është mbajtur një ceremoni për ta përkujtuar 27-vjetorin e Epopesë së UÇK-së dhe për ta nderuar kujtimin e komandantit Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit që ranë për liri. Në këtë aktivitet u zhvillua ceremonia e rreshtimit të kuadrateve të FSK-së, me pjesëmarrjen e liderëve shtetërorë, duke përfshirë presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti, kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca, ministrin e Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim

Jashari, ministra dhe zëvendësministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës, zyrtarë të lartë të MM-së, gjeneralë dhe ushtarakë të lartë të FSK-së, si dhe autoritete të tjera politike,

diplomatike dhe ushtarake, vendore dhe ndërkombëtare. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thanë se familja Jashari është themeli mbi të cilën është ngritur liria e





Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kryeministri Albin Kurti në fjalën e tij tha se sot, në 27-vjetorin e Epopesë së UÇK-së, “vazhdojmë ta ruajmë pothuajse të njëjtën traditë, vetëm se skenarin e dikurshëm të organizuar nga UÇK-ja, e kanë formalizuar në protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës”. “Këty shteti për të cilin u luftua dhe u flijua aq shumë. Të dashur pjesëtarë të ushtrisë së Kosovës, të veshur me uniformën më të lavdishme, të bukur e tash edhe moderne, ju po mbani armë dhe flamuj në duar, teksa qëndroni të rreshtuar në shenjë gatishmërie dhe nderimi në përkujtim dhe mirënjohje të atyre që i vunë themelet e ushtrisë së Kosovës: Kryekomandantit Adem Jasharit, familjes Jashari dhe të tjerëve që udhëtuan me ta”, ka thënë Kurti.

Ai ka thënë se Ushtria e Kosovës, që zuri fill më 1989 me grupin e Adem Jasharit në Drenicë, u ngjiz me disa pak armë personale dhe pajisje ushtarake, por që mbaheshin nga një grup njerëzish me përkushtim të madh dhe me vullnet të paepur. “Gjatë viteve ’90 dhe në kohën e luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, armët, municionet, uniformat dhe pajisjet e tjera ushtarake, kurrë nuk qenë të mjaftueshme dhe të bollshme për luftën e UÇK-së për lirinë e Kosovës”, ka thënë Kurti, duke shtuar se që nga çlirimi i atdheut në qershor 1999 dhe deri më sot e tutje, një nga detyrat kyçe për ruajtjen e lirisë së fituar me gjakun e dëshmorëve dhe martirëve të popullit tonë, ka qenë dhe vazhdon të mbetet fuqizimi i ushtrisë së Kosovës. “Prandaj sot, me ngazëllim mund të konstatoj,

që qysh nga viti 1989 kur Adem Jashari me shokë filluan të flasin e të punojnë për një Ushtri të Kosovës dhe deri sot, kurrë nuk kemi pasur një ushtri më të fortë, më të armatosur, më të pajisur dhe më të trajnuar se sa sot”, ka deklaruar Kurti. Kurti ka theksuar se blerjet e sistemeve të armatimit dhe pajisjeve sipas konceptit shtet me shtet si dhe shtet me prodhues, përveç që i kanë pakësuar hallkat e procedimit të blerjeve, kanë siguruar armatime moderne të cilësisë së lartë me çmime shumë herë më të favorshme nga sa paguhej më parë si dhe e kanë thelluar bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me vendet e anëtare të NATO-s. Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë se Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe datat 5, 6 e 7 mars janë

emblema e qëndresës, e luftës për çlirimin e atdheut deri në vetëmohim. “Lufta e komandantit legjendar Adem Jashari, e grupeve të armatosura të Ushtrisë Çlirimtare, qëndresa sypatrembur ndaj okupatorit, e motivi i çiltër për çlirim, ishin arsyeja për të fituar përkrahjen e aleancës së NATO-s, duke i dhënë fund terrorit serb, e dritë shtetit të ri demokratik, Republikës së Kosovës. Ai është gjallë, i gjallë në mendjet e zemrat tona, sepse trimëria e sakrifica e komandantit legjendar Adem Jashari e familjes së tij nuk mund të harrohet kurrë. Sot, Adem e Hamëz Jashari, jetojnë në mesin e trupave të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në krenarinë e vullnetin e hekurt të ushtarakëve tanë që denjësisht bartin emblemën e shqiponjës, mbrojtësit tanë sypatrembur të lirisë dhe tërësisë

territoriale të Republikës së Kosovës. Shtet e ushtri, ishte pikërisht ëndrra e Ademit e Hamzës që është jetësuar e po konsolidohet çdo ditë e më shumë”, ka thënë Maqedonci. Homazhe në Komplexin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz kanë bërë edhe liderët e opozitës, deputetë të Kuvendit të Kosovës, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari dhe qytetarë të shumtë. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se 27 vjet më parë, më 5, 6 dhe 7 mars, në Prekazin e shenjtë, qëndresa u bë betim, flijimi u bë udhërrëfim, e familja Jashari u ngrit në përjetësi. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se sot është te Prekazi i komandantit legjendar Adem Jashari, aty ku sakrifica arriti kulmin.



AGIM SHAHINI: KOSOVA T’I HEQË TAKSAT DOGANORE PËR TË GJITHA PRODUKTET MADE IN USA

PRISHTINË, 5 MARS - Fjalimi i presidentit Donald Trump në Kongres rreth 100 minuta do të ketë një ndikim të rëndësishëm në shumë aspekte si për botën ashtu edhe për Kosovën, duke pasur parasysh kontekstin politik, krizat ekonomike, luftën në Ukrainë dhe marrëdhëniet e tjera ndërkombëtare. Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka vlerësuar disa aspekte të mundshme që lidhen me këtë fjalim sa i përket botës për politikën ekonomike dhe tregtare. “Trumpi ka qenë i njohur për fokusin e tij në politikën proteksioniste dhe përpjekjet për t’i mbrojtur interesat ekonomike të ShBA-së. Fjalimi ishte i lidhur me këto

tema nga 2 prilli - taksat për import të disa shteteve dhe këto mund të ndikojnë në politikën tregtare ndërkombëtare dhe marrëdhëniet e ShBA-së edhe me shtetet e tjera. Kjo do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në tregjet globale, duke përfshirë ato të energjisë dhe burimeve të tjera prodhuese dhe shërbime tregtare. Presidenti shprehu qëndrime të ashpra ndaj disa shteteve ose organizatave ndërkombëtare. Kjo mund të pasqyrohet një rritje e paqes ose tensioneve globale, duke pasur parasysh fuqinë ekonomike, politike dhe ushtarake të Amerikës në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe stabilitetin global. Sa i përket Kosovës dhe



marrëdhënieve me ShBA-në, presidenti Trump ka pasur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e Kosovës, sidomos në periudhën e administratës së tij. Një fjalim i

tij në Kongres mund të ndihmojë në forcimin e marrëdhënieve midis dy shteteve, veçanërisht iniciativat për investime, zhvillimin ekonomik dhe mbështetje për

integrimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Siguria dhe stabiliteti rajonal, stabiliteti i Ballkanit mund të ndikojnë në mbështetje për Kosovën dhe ekonominë tonë”, ka thënë Shahini. Ai ka thënë se njohja e fundit e Kosovës ishte nga Izraeli e ndikuar drejtpërsëdrejti nga president Trump gjatë udhëheqjes së kryeministrit Avdullah Hoti. “AKB-ja i propozon Qeverisë së re të Kosovës për të qenë më afër me administratën Trump që t’i heqë taksat doganore për të gjitha produktet Made in USA, si hap i parë për të nxitur importe dhe bashkëpunimin edhe më të madh me këtë shtet mik të Kosovës”, ka thënë Shahini.

REFUZIMI I DËSHMIMIT NË PROKURORI NGA KRYEMINISTRI KURTI ËSHTË PËRPPJEKJE PËR PENGIM TË DREJTËSISË KUNDËR KORRUPSIONIT



Shkruan: Hajdin ABAZI

Albin Kurti, si kur ishte aktivist, ashtu edhe deputet opozitar dhe tash në cilësinë e kryeministrit, vazhdimisht ka pasur fërkime me drejtësinë, duke u përpjekur ta pengojë atë, pasi që ai mendon se fjala e tij duhet të jetë vetë drejtësia e jo ligjet dhe kushtetuta. Sigurisht, drejtësia e Kosovës ka nevojë për ndryshime kualitative ashtu që t'i përafrohet nivelit të drejtësisë evropiane, edhe pse as kjo, në atë që po shihet në procesin gjyqësor në Hagë, nuk është gjithherë korrekte dhe lë vend për të dëshiruar për paanësi dhe qasje ndaj fakteve dhe fakteve të stisura ndonëse ende nuk është dhënë verdikti nga kjo gjykatë. Nëse drejtësia e Kosovës ka refuzuar t'i nënshtrohet autoritarizmit të Kurtit dhe për aq sa do të vazhdojë ta bëjë këtë, ajo është duke bërë veprimin më të drejtë të mundshëm në mbrojtje të

integritetit të vet si drejtësi, të ligjshmërisë dhe Kushtetutës, të paktën në këtë rast. Nëse Albini mendon ta reformojë drejtësinë dhe ta ngrisë në nivel më të lartë, ai po i qaset kësaj në mënyrë krejt të gabuar. Nuk mund ta përmirësosh dikën duke e etiketuar si gjoja po e mbron korruptionin kur pikërisht për korruption nuk po shkon të ndihmosh drejtësinë duke dhënë dëshminë tënde. Refuzimi i Albinin si kryeministër është një shembull i keq, që e mëson secilin qytetar që t'i thotë prokurorisë eja në vendin e punës anë plazh kur jam në pushime e më intervisto - eja "po guxove", dhe kështu e ushqen mosbindjen qytetare ndaj sistemit të drejtësisë. Në vend të kësaj, Albin Kurti, mu si kryeministër do të duhej të jepte shembullin e një qytetari të virtytshëm e të ndershëm duke iu bindur urdhrin të prokurorisë. Këtu më vije ndërmend Sokrati, i cili padrejtësisht u dënua me vdekje, dhe kur iu afrua oferta për të ikur, ai refuzoi, vetëm e vetëm për të treguar se është gabim t'i iket drejtësisë. Por kryeministri Kurti nuk e ka një virtyt të tillë. Ai e kishte rastin që në fillim të tregonte se nuk abuzon me pushtetin për t'u mbrojtur nga drejtësia. Por ai

po e bën të kundërtën. Ai po e shkakton një konflikt midis ekzekutivit dhe drejtësisë. Merreni me mend sikur gjyqi të lëshojë urdhrë për arrestimin e Albin Kurtit, dhe ja konflikti: policia që kujdeset për të a do ta përfillte urdhrin për arrest apo për mbrojtje të tij? Kurti ishte një mandat të plotë në qeverisje dhe i kishte të gjitha mundësitë ta ndihmonte drejtësinë për t'u përmirësuar dhe avancuar, duke iu afruar mbështetje në ndjekjen e të korruptuarve dhe duke ju ofruar kondita më të mira pune. Dhe Albini është për me e luftua korruptionin, porse vetëm ndaj atyre që nuk janë me të, kurse për secilin që ka vepër korruptioni dhe është me Albinin - aty drejtësia "vepron me hile"! Përtej kësaj, duket se Kurti po ka nevojë për skandal, për acarimin e konfliktit midis ekzekutivit dhe gjyqësisë, me qëllim ndoshta që të nxiste reagim qytetar që mund të përfundonte në një kryengritje për të përmbysur sistemin e drejtësisë, që pastaj t'i vendos njerëzit e tij në pozita relevante në drejtësi dhe drejtësia të shoh me dioptrinë e Kurtit. Edhe po ta bëj këtë, ai do të ketë pengesa të mëdha, së pari, sepse nuk dihet epilogu dhe dhuna mund të përfundojë në tragjedi; së dyti, Bashkimi Evropian dhe

ShBA nuk do ta pranonin një puç të tillë ndaj drejtësisë nga që do të ishte një presedan i rrezikshëm. Kurti e di se në këto rrethana globale pas ardhjes së Trumpit sërish president i ShBA nuk ka më hapësirë manovrimi me veriun dhe minoritetin serb, po duhet të implementojë Marrëveshjen e Ohrit dhe atëherë do të shihet se ai ka pranuar autonomi për veriun dhe këtë nuk do te mundet t'ua adresojë as Thaçit e as Mustafës, po do të jetë vepër e tij që do ta demaskojë politikisht e kombëtarisht. Për më tepër, kryeministri Kurti, në mënyrën si po artikullohet, po lë përshtypjen sikur ai po bën një akt patriotik, sepse po ju kundërvihet prokurorëve e gjyqtarëve që "më shume e luftojnë qeverinë se sa korruptionin". Po gjithkund në botë korruptioni bëhet nga qeveritarët, e jo nga njerëzit që nuk kanë qasje në tenderë e rrugë të tjera përfitimi jo të ligjshëm. Nëse Albini është njëmend i lexueshëm sikurse thonë, ai duhet ta dijë se kështu kanë menduar të gjithë njerëzit në udhëheqje të pushtetit, të cilët kanë përfunduar në autoritarë ose edhe në diktatorë, dhe kanë pasur fund të pakëndshëm. Sikurse të ishte ftesa e prokurorisë për dëshmi, le të

themi, për lotsjellësit në Kuvendin e Republikës, duke qenë ato veprime me motive politike, mbase edhe mund te justifikohet, edhe pse nuk do të duhej ta bënte. Por jo. Ai është i ftuar nga prokuroria të dëshmojë për një rast korruptioni dhe abuzimi me paratë e shtetit. Po, po, për çështje korruptioni është ftuar Kurti të dëshmojë. Të dëshmojë se a është kryer korruption apo jo. Por ai po i ikë kësaj dëshmie. Dhe me këtë, ai, në mënyrë të tërthortë, po e mbron korruptionin dhe po përpigjet ta pengojë drejtësinë për të ndriçuar të vërtetën. Kryeministër Kurti ka përvojë me dëshmime para organeve të drejtësisë, dhe e di se askush nuk mundet ta detyrojë të nënshkruajë diçka që ai nuk e ka thënë e nuk e ka pohuar. Atëherë, përse ai po i ikë dëshmisë? Mbase, për shkakun se e di se ka fakte prokuroria dhe nuk mundet t'i mohojë dhe mundet që edhe vetë të jetë drejtpërdrejt i involvuar. Ndryshe, po të ishte vet i pastër, nuk do të kishte asnjë arsye reale për t'i ikur dhënies së dëshmisë, ku do të mund të tregonte pafajësinë e vet. Prandaj, kryeministër, mjaft i ike drejtësisë: shko e jep dëshmi! Shko, se nuk i ikë dot përgjithmonë drejtësisë!

Osmani diskuton me komandantin e KFOR-it për sigurinë dhe stabilitetin



PRISHTINË, 5 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është takuar me komandantin e misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, Enrico Barduani, me të cilin ka thënë të ketë diskutuar për sigurinë dhe stabilitetin e vendit e rajonit, si dhe për koordinimin e aktiviteteve në prag të vizitës së paralajmëruar të sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte në Kosovë. Rutte pritet ta vizitojë Kosovën më 11 mars për herë të parë prej kur e ka marrë këtë pozitë. Gjatë vizitës në Kosovë, Rutte pritet të jetë i shoqëruar nga

ambasadorët e vendeve anëtare të NATO-s, që janë anëtarë të Këshillit të Atlantikut të Veriut. Presidenca e Kosovës ka thënë përmes një komunikate se gjatë takimit të Osmanit me komandantin e KFOR-it, presidentja e ka përmendur rolin e këtij misioni në ruajtjen e sigurisë dhe paqes në Kosovë. "Kontinenti ynë po përballlet me një situatë të ndërlikuar gjeopolitike, e cila kërkon bashkëpunim të ngushtë dhe koordinim të përhershëm me aleatët tanë", është cituar të

ketë thënë Osmani, sipas komunikatës. Javë më parë Rutte ka thënë se stabiliteti në Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë dhe në Serbi është në interes të të gjithëve dhe nuk sheh arsye të besojë që mund të ketë ndonjë ndryshim dramatik sa i përket përkushtimit amerikan në aleancën ushtarake perëndimore. Ai i pati bërë këto komente në një diskutim me studentë në Sllovakia, pasi ishte pyetur nëse sheh mundësi për rifillim të konfliktit në Kosovë, pasi veçse ka pasur raportime në disa

medie se politika e re amerikane mund të rezultojë me tërheqje të pranishë ushtarake. Përveç Kosovës, zvogëlimi ose tërheqja e trupave ushtarake amerikane janë përfolur edhe në disa vende evropiane, por administrata e presidentit amerikan, Donald Trump, nuk ka konfirmuar diçka të tillë. NATO ka mision paqeruajtës në Kosovë që nga përfundimi i luftës më 1999. Aktualisht në kuadër të KFOR-it janë mbi 4 600 trupa nga 29 vende të botës që janë të dislokuar në Kosovë.

Numri më i madh i tyre është nga Italia, pasuar nga Shtetet e Bashkuara, Hungaria dhe Turqia. Ky mision e ka shtuar praninë në Kosovë gjatë vitit 2023, pas rritjes së tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe. KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EULEX. Ky mision, veç të tjerash, është përgjegjës për sigurinë e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Regjistrohen mbi 230 000 votues nga diaspora për zgjedhjet e 11 majit në Shqipëri

TIRANË, 5 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Shqipërisë (KQZ) njoftoi të mërkurën se 232 000 votues jashtë vendit janë regjistruar për të votuar në zgjedhjet parlamentare të 11 majit në Shqipëri. Kjo është hera e parë që diaspora shqiptare voton në zgjedhje parlamentare në Shqipëri. Mesnata e së martës ishte afati i fundit i vendosur nga KQZ-ja për regjistrimin e votuesve nga jashtë. Sipas të dhënave zyrtare të KQZ-së, edhe 20 000 kërkesa janë duke u shqyrtuar për të parë nëse dokumentacioni është i rregullt. Komisioni ka pesë ditë kohë për shqyrtimin e tyre dhe për ta shpallur numrin përfundimtar të votuesve nga jashtë.

KQZ-ja i pranoi në përgjithësi 294 025 kërkesa, por rreth 42 000 prej tyre janë hedhur poshtë për shkak të parregullsive në dokumentet e paraqitura. Numri më i lartë i votuesve nga jashtë u regjistrua në Itali, rreth 148 000, pastaj në Greqi rreth 103 000, si dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Francë, Belgjikë etj.



Nga Kosova janë regjistruar 215 votues. Nga rreth 30 shtete, përfshirë këtu edhe territorin palestinez, ka pasur vetëm nga një kërkesë. Sipas një raporti të Institutit të Statistikave në vitin 2020, numri i asaj që njihet si "diaspora e re", apo imigrantët e larguar gjatë viteve '90 nga Shqipëria, ka arritur në rreth 1.68 milion.

Përfaqësuesit e Partisë Demokratike në opozitë kërkuar të shtyhej afati për

regjistrimin e votuesve nga jashtë, ndërsa Partia Socialiste në pushtet kërkoi shtyrje afati vetëm për ata votues, kërkesat e të cilëve janë refuzuar.

Megjithatë, KQZ-ja vendosi të mos ketë shtyrje të afatit, pasi do ta ndërlikonte procesin e shpalljes së listës dhe rishikimit të saj nëse do të jetë e nevojshme. Ajo pritet ta publikojë listën e votuesve nga jashtë më 9 mars. Regjistrimi për diasporën nisi më 11 janar.

Si do të votojë diaspora shqiptare?

Fletëvotimet do t'u dërgohen votuesve nga jashtë përmes operatorëve ndërkombëtarë të postave që kanë degë në Shqipëri, e më pas votat e tyre do të sillen në Shqipëri. Shpenzimet për këtë proces përballohen nga buxheti i shtetit.

Kreu i Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve, Ilirjan Celibashi, ka deklaruar se vota nga jashtë do të ketë ndikim në rezultatin e zgjedhjeve të 11 majit. "Matematikisht janë 23-25 mandate që mund të ndikohen prej votave nga jashtë", tha Celibashi.

Për zgjedhjet e 11 majit janë regjistruar 51 subjekte politike, ndërsa kanë paraqitur kërkesë për regjistrim tre koalicionet parazgjedhore.

Koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Madhështore" udhëhiqet nga Partia Demokratike e Sali Berishës dhe ka në përbërjen e saj Partinë e Lirisë së Ilir Metës dhe 24 aleatë të tjerë.

Koalicioni "Djathtas për Zhvillim", ku bëjnë pjesë dy parti të drejtuara nga ish-përfaqësues të Partisë Demokratike. Koalicioni tjetër është "Nisma Shqipëria Bëhet", që ka në përbërje parti të reja që vijnë nga shoqëria civile.

Në këto zgjedhje Partia Socialiste në pushtet, e drejtuar nga kryeministri Edi Rama, kërkon mandatin e katërt, ndërsa demokratët kërkojnë ndryshim politik dhe rikthimin në pushtet pas 12 vjetësh në opozitë.

Shtyhet seanca fillestare për dy të dyshuarit për spiunazh

PRISHTINË, 5 MARS - Seanca fillestare për dy të dyshuarit për spiunazh, Bedri Shabani dhe Muharrem Qerimi, është shtyrë për 17 mars.

Gjykatësi Rrahman Beqiri tha gjatë seancës të mërkurën se ka caktuar seancë të re fillestare për 17 mars për shkak se i dyshuari Bedri Shabani kërkoi kohë për ta lexuar akuzën me të cilën ngarkohet.

Avokat i Shabanit, Besnik Berisha, tha se klienti i tij ka nevojë për disa ditë kohë për ta kuptuar akuzën para se ta bëjë deklarinimin e tij rreth fajësisë. Ndërkohë, Qerimi tha se e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk ka asgjë të paqartë.

Muajin e kaluar Prokuroria Speciale e Kosovës u ngriti



aktakuzë Shabanit dhe Qerimit, nën dyshimin se e kanë kryer veprën penale të spiunazhit. Ata u arrestuan në qershor të vitit të kaluar në qytetin e

Ferizajt.

Sipas aktakuzës, Bedri Shabani e ka ndihmuar Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Serbisë, e njohur si BIA, para

fillimit të luftës së viteve 1998-'99 në Kosovë dhe deri në arrestimin e tij në vitin 2024.

Shabani akuzohet se ka mbledhur informata, dokumente dhe materiale që ndërlidhen me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), përfshirë eprorët e saj, si dhe për ngjarje dhe objekte specifike, si Spitali Ushtarak i UÇK-së - dhe ia ka dërguar ato BIA-s përmes komunikimeve telefonike, postës elektronike dhe takimeve fizike në territorin e Serbisë. Sipas Prokurorisë, me këto veprime Shabani e ka rrezikuar dhe dëmtuar rëndë rendin juridik kushtetues dhe sigurinë e Kosovës.

Ndërkohë, Muharrem Qerimi

akuzohet se e ka ndihmuar BIA-n nga viti 2012 deri në vitin 2024, duke i dërguar asaj informata, dokumente dhe materiale të ndryshme në lidhje me luftën dhe pjesëtarët e UÇK-së, emrat e eprorëve të Policisë së Kosovës, Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK).

Qerimi është përmendur edhe për dyshimet për kryerje të veprës penale "mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim i paautorizuar i armëve".

Policia e Kosovës kishte konfiskuar armë, municione dhe maska ushtarake gazi në dy lokacionet e Shabanit dhe Qerimit në Ferizaj vitin e kaluar.

Gjenden eshtra në fshatin Obranqë të Podujevës, dyshohet se mund të jenë të personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës

PODUJEVË, 5 MARS - Të mërkurën gjatë gërmimeve në fshatin Obranqë, komuna e Podujevës, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur, në bashkëpunim me Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) dhe Policinë e Kosovës, kanë hasur në eshtra që dyshohet se mund të jenë të personave nga lista e

personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës në Kosovë. Në njoftimin për medie thuhet se aktualisht eshtrat e gjetura janë duke u ekzaminuar nga ekspertët e IML-së me qëllim të identifikimit të saktë. "Këto gërmime u realizuan në bazë të informacionit që qytetarët kishin ndarë në fund të muajit

janar, për çka ju jemi mirënjohës", bëhet me dije në njoftimin për medie. Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur shpreh përkushtimin e tij të vazhdueshëm në zbardhjen e fatit të çdo personi të zhdukur dhe inkurajon qytetarët të vazhdojnë të ofrojnë informacione të vlefshme.



96.7 % e ekonomive familjare kanë në pronësi me akt ligjor shtëpitë/banesat

PRISHTINË, 5 MARS - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës 2023. Sa i përket shkallës së pronësisë së shtëpive dhe banesave, 96.7 % e ekonomive familjare kishin në pronësi me akt ligjor shtëpitë/banesat, 1 % e ekonomive familjare ishin qiramarrës ose nënqiramarrës që paguajnë qira me normën e tregut, ndërsa për 2.3 % të

ekonomive familjare akomodimi ofrohet falas. Rreth 90.4 % e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se jetojnë në shtëpi të veçuar, të ndarë në vete, 2.6 % e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se jetojnë në shtëpi gjysmë të ndarë dy banesa, 1.1 % e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se jetojnë në ndërtesa me më pak se 10 banesa, ndërsa 5.9 %

e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se jetojnë në ndërtesa me më shumë se 10 banesa. Rreth 86.2 % e ekonomive familjare ishin në gjendje ta përballojnë mbajtjen e shtëpisë së ngrohtë në mënyrë adekuate, përderisa për 13.8 % të ekonomive familjare ishte e papërbalueshme mbajtja e shtëpisë së ngrohtë në mënyrë adekuate.




Shqiptarët, më pak të paguarit për orë në Evropë

TIRANË, 5 MARS - Punonjësit shqiptarë janë më të nënpaguarit në Evropë sa i përket pagës që ata marrin në një orë, ashtu dhe fuqisë blerëse, apo produkteve që mund të blejnë me të. Sidomos për fuqinë blerëse, me pagën e një ore në Shqipëri mund ta blesh gjysmën në krahasim me vendet e rajonit, si Serbia, Bosnjë - Hercegovina, Maqedonia e Veriut, apo Mali i Zi.

Të dhënat janë bërë të ditura në një raport të fundit të Eurostatit, që krahason pagën për orë në euro dhe të matur sipas fuqisë blerëse (PPS) në vendet e Bashkimit Evropian dhe ato kandidatë për vitin 2022 (të dhënat për Kosovën mungojnë).

Punonjësit shqiptarë, sipas të dhënave, paguhet 2.47 euro në orë, në krahasim me punonjësit serbë që marrin gati dyfishin, në 4.43 euro në orë, apo në Bosnjë me 4 euro. Të dhënat për Malin e Zi nuk janë përditësuar, por ata paguheshin 3.42 euro për orë që në vitin 2014 dhe maqedonasit 2.2 euro po në 2014-n.

Femrat në Shqipëri paguhet 2.63 euro në orë, ndërsa meshkujt 2.39 euro, sipas statistikave të Eurostatit. Sipas standardit të fuqisë



blerëse (PPS), që i bën të dhënat më të krahasueshme për shkak se eliminon diferencat mes çmimeve, Shqipëria renditet sërish e fundit me pagën orare prej 4.62 PPS, përkundrajt 7.6 PPS në Serbi dhe 8.7 PPS në Bosnjë.

Maqedonia e Veriut e kishte këtë tregues 5.2 që në 2018-n (kur në Shqipëri ishte 3.2) dhe Mali i Zi 6.2 që në 2014-n. Sipas të dhënave të tetorit 2022, paga bruto mesatare për orë pune, e shprehur në euro, tregon dallime të mëdha mes

vendeve të Bashkimit Evropian. Paga më e lartë mesatare bruto për orë u regjistrua në Danimarkë me 29.8 euro, e ndjekur nga Luksemburgu (24.0 euro), Belgjika (23.8 euro), Irlanda (20.3 euro), Gjermania (19.4

euro), Finlanda dhe Suedia (me 19.3 euro secila) si dhe Holanda (19 euro), referon Eurostat.

Në anën tjetër, pagat më të ulëta mesatare bruto për orë u regjistruan në Bullgari (4.1 euro), Rumania (5.6 euro), Hungari (5.7 euro), Portugali (6.2 euro), Kroaci (6.8 euro) dhe Poloni (6.9 euro).

Në shkallë të përgjithshme paga mesatare më e lartë për orë në një vend të BE-së ishte 7.4 herë më e lartë se ajo më e ulëta. Sipas fuqisë blerëse, paga mesatare bruto për orë në nivel kombëtar, në tetor 2022, ishte 3.3 herë më e lartë në vendin me pagën më të lartë krahasuar me atë më të ulët, kur shprehet në standarde të fuqisë blerëse (PPS), një njësi që eliminon ndryshimet e niveleve të çmimeve mes vendeve.

Pagat më të larta mesatare bruto për orë, të shprehura në PPS, u regjistruan në Danimarkë (22.4 PPS), Belgjikë (21.3 PPS), Luksemburg (18.4 PPS), Gjermani (17.3 PPS) dhe Irlandë (17.0 PPS). Në anën tjetër të shkallës, pagat më të ulëta mesatare bruto për orë u regjistruan në Bullgari (6.7 PPS), Portugali (7.4 PPS), Hungari dhe Letoni (8.9 PPS secila), Kroaci (9.4 PPS), Sllovaki (9.7 PPS), Greqi (9.8 PPS) dhe Rumania (9.9 PPS).

Dogana e Kosovës merr pjesë në takimin e nënkomitetit të OBD-së për integritet

PRISHTINË, 5 MARS - Këtë javë, në selinë e Organizatës Botërore të Doganave (OBD) në Bruksel, po mbahet takimi i 24-t i Nënkomitetit për Integritet.

Delegacioni i Doganës së Kosovës po merr pjesë aktivisht në këtë ngjarje të rëndësishme, duke dëshmuar angazhimin e palëkundur për forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit në administratën doganore.

Dogana e Kosovës shpreh mirënjohjen e saj ndaj OBD-së dhe të gjithë prezantuesve për diskutimet dhe kontributet e vlefshme. "Një falënderim i veçantë u shkon donatorëve,

veçanërisht Norvegjisë dhe Kanadasë, për mbështetjen e vazhdueshme në kuadër të Programit A-CIP", theksohet në njoftimin për medie.

Hapat kryesorë të ndërmarrë për forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit: Plani i Integritetit 2024-2026 - miratuar në përputhje me udhëzimet e OBD-së dhe politikat qeveritare, duke përcaktuar qasjen strategjike për integritetin institucional; Deklarimi i detyrueshëm i pasurisë për të gjithë zyrtarët doganorë, si një masë thelbësore për rritjen e transparencës; Përditësimi i Kodit të Etikës, i harmonizuar

me Deklaratën e Rishikuar të Arushës, për t'i forcuar standardet profesionale dhe etike; Platforma elektronike për raportimin anonim të korrupsionit, duke siguruar mekanizma efektivë për denoncime dhe rritjen e llogaridhënies; Rekrutimi i 115 zyrtarëve të rinj doganorë, procesi më i madh i punësimit që nga viti 2008, i vlerësuar për transparencë dhe barazi në përzgjedhje; Zgjerimi i bashkëpunimit me agjencitë e zbatimit të ligjit, për të forcuar përpjekjet ndërinstitucionale në luftën kundër korrupsionit. Përmes këtyre masave të rëndësishme Dogana e



Kosovës rikonfirmon përkushtimin ndaj integritetit, transparencës dhe qeverisjes

së mirë, duke ndjekur standardet dhe praktikat të mira ndërkombëtare.

“HAKMARRJA” E PEKINIT: ‘JEMI GATI PËR ÇDO LLOJ LUFTE’

Fermerët amerikanë në krizë. Importet e sojës në shënjestër. Pekini vë në shënjestër 15 kompani amerikane, përfshirë prodhuesit e dronëve nga Silicon Valley dhe industritë bioteknologjike. Çështja e Taivanit dhe industria e mikroçipave



Pas një muaji fjalësh dhe kërcënimesh, vendimet e Donald Trump po fillojnë të ndihen edhe në ekonomi. Tarifat e reja doganore që prekin Kinën, armikun historik të Uashingtonit, tregojnë se Trump 2.0 mund të minojë përgjithmonë ekuilibrin e viteve të fundit. Pikërisht Pekini, i goditur nga tarifat e reja prej 10% për të gjitha mallrat që hyjnë në Shtetet e Bashkuara, ka reaguar duke deklaruar se nuk do të qëndrojë duarkryq, por do të kundërpërgjigjet me një ton të ndryshëm nga heshtja që kishte mbajtur muajt e fundit. Ministri i Jashtëm kinez, Lin Jian, deklaroi: “Nëse Shtetet e Bashkuara insistojnë të nisin një luftë tregtare, një luftë ekonomike apo çfarëdolloj konflikti tjetër, atëherë pala tjetër do të luftojë deri në

fund, por fundi do të jetë i hidhur për të gjithë.”

Fermerët amerikanë në krizë

Nga 10 marsi, do të hyjnë në fuqi tarifa prej 15% mbi grurin, misrin dhe elbin, si dhe një rritje prej 10% mbi importet e sojës, mishit të derrit dhe viçit, peshkut, frutave, perimeve dhe produkteve të tjera bujqësore. Përveç kësaj, do të ndalohet importi i drurit nga SHBA, një katastrofë për fermerët dhe blegtorët amerikanë që vitet e fundit kishin votuar masivisht për Trumpin. Vlen të kujtohet se Shtetet e Bashkuara eksportuan 12.8 miliardë dollarë në sojë drejt Kinës në vitin 2024, duke e bërë atë importuesin e tretë

më të madh të këtij produkti nga SHBA. Në të kaluarën, gjatë luftës tregtare të viteve 2018-2019 midis Trump dhe Kinës, fermerët amerikanë u dëmtuan aq rëndë nga tarifat hakmarrëse të Pekinit, sa që qeveria federale u detyrua të ndërhynte me 28 miliardë dollarë subvencione për të mbështetur sektorin bujqësor.

Fentanili dhe një tjetër betejë

Edhe në këtë rast, Trump kishte filluar luftën tregtare duke premtuar ndalimin e trafikut të fentanilit, por nuk arriti të zgjidhë problemin dhe shumë analistë besojnë se kjo betejë do të mbetet e hapur. Përgjigja e Kinës, si gjithmonë, është asimetrike, duke goditur

sektorë të ndryshëm të ekonomisë amerikane. Pekini vë në shënjestër 15 kompani amerikane, përfshirë prodhuesit e dronëve nga Silicon Valley dhe industritë bioteknologjike. Në mesin e kompanive të vëna në shënjestër nga tarifat e reja janë prodhuesit amerikanë të dronëve si Skydio, si dhe kompania e inteligjencës artificiale Shield AI, e cila prodhon pajisje me përdorim të dyfishtë (civil dhe ushtarak). Gjithashtu, industritë bioteknologjike që kanë marrëdhënie të ngushta me Kinën janë në shënjestër të hakmarrjes kineze. Pekini ka paralajmëruar se do të denoncojë Shtetet e Bashkuara në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) për tarifat e reja, një veprim që kishte ndërmarrë edhe në shkurt, kur Trump

miratoi tarifat e para 10% mbi produktet kineze. Çështja e Tajvanit dhe industria e mikroçipave. Një tjetër çështje e ndjeshme është Tajvani. Administrata amerikane po përpaket të zhvendosë prodhimin e mikroçipave në SHBA. Këtë javë, presidenti amerikan ka firmosur një marrëveshje prej 100 miliardë dollarësh për 4 vitet e ardhshme me kompaninë tajvaneze Taiwan Semiconductor Manufacturing (TSMC). Pekini e ka parë këtë lëvizje si një përpjekje për të dobësuar varësinë teknologjike të SHBA nga Azia dhe e ka cilësuar si një strategji për të ruajtur mbizotërimin kombëtar. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Zhegrova mungon ndaj Islandës

Edon Zhegrova pritet të jetë mungesa e madhe te Kombëtarja e Kosovës për ndeshjet e këtij muaji kundër Islandës në kuadër të “play-off”-it të Ligës së Kombeve. Zhegrova nuk ka luajtur që nga dhjetori i vitit të shkuar për shkak të lëndimit dhe, sipas të gjitha gjasave, pritet të rikthehet në fushë në fillim të muajit prill. 25-vjeçari është rikthyer në stërvitje te Lille, por ende nuk është i gatshëm për lojë dhe për këtë arsye pritet të mos ftohet nga përzgjedhësi Franco Foda. Kosova do të përballlet me Islandën për promovim në Ligën B, me ndeshjen e parë që do të luhet në Prishtinë më 20 mars dhe të dytën në Spanjë tri ditë më vonë.

Portierja Aurora Kryeziu transferohet te Mainzi



PRISHTINË, 5 MARS - Portierja e parë e Kombëtares së Kosovës në hendboll, Aurora Kryeziu, ka bërë hap të rëndësishëm në karrierë. 20-vjeçarja prej edicionit të ardhshëm do të jetë pjesë e klubit të njohur gjerman Mainz. Mainz aktualisht garon në Bundesliga 2, ndërsa është prej skuadrave të pjesës së epërme të tabelës. Kryeziu deri më tani ishte te TSG Bretzenheim, që është i fundit në tabelë në Bundesliga 2 të Gjermanisë. Ajo ishte transferuar te TSG Bretzenheim në vitin 2023 nga

Blomberg-Lippe. E ndihmoi skuadrën Brtzenheim që të promovohet në kategorinë e dytë gjermane. Këtë edicion ka bërë 125 pritje, përkatësisht 6,6 pritje për ndeshje. “Pas një vlerësimi të kujdesshëm, kam vendosur të largohem nga TSG. Ky vendim është i bazuar në arsye sportive që më dërgojnë në një drejtim të ri. Shikoj para te koha në Mainz, por jam plotësisht e fokusuar për ta siguruar mbetjen në divizionin e dytë me TSG-në. Do të bëj çdo gjë të mundshme për të siguruar që të mbetemi në

divizionin e dytë”, ka thënë Kryeziu. Ajo ka shfaqur nivel të lartë edhe në Kombëtaren e Kosovës, ndërsa te Mainzi e vlerësojnë shumë. “E kemi përcjellë nga afër Aurora Kryeziun prej se kaloi nga Blombergu te TSG. Na ka bindur me paraqitjet e saj në derbi dhe në ndeshjet e tjera të divizionit të dytë”, ka thënë Eva Federhenn, drejtore të sportive të Mainz 05. Aurorën e presim muajin e ardhshëm për ndeshjet me Suedinë, që janë të fazës së fundit kualifikuese për Kampionat Botëror.

SHKURT

Korenica zgjidhet lojtari i muajit te Cluji

Meriton Korenica është duke kaluar një formë mjaft të mirë së fundmi. Futbollisti nga Kosova me golat dhe paraqitjet e tij e ka ndihmuar ekipin e tij Cluj të arrijë rezultate pozitive. E sipas një postimi të ekipit rumun, Korenica është zgjedhur lojtari më i mirë i muajit shkurt te ky klub.

Djali i Rudi Vatës ftohet nga Irlanda

Rocco Vata është ftuar nga Irlanda për ekipin e parë në prag të fillimit kualifikuesve të Botërorit. Talenti 19-vjeçar nuk ka përfaqësuar Shqipërinë në asnjë grupmoshë më parë, ndërsa kjo duket të jetë zgjedhja përfundimtare e tij. Vata ka bërë mjaft mirë me Watfordin. Në sezonin e tij të parë, deri tani, ka shënuar 4 gola dhe ka dhuruar tri asistime. I dalë nga akademia e Celticut, Rocco Vata do ta ketë mundësinë ta veshë fanellën e Irlandës. Irlanda do ta luajë sfidën e parë me Zvicrën më 21 mars. Një takim ky ku Vata pritët të jetë në dispozicion të skuadrës A për herë të parë duke humbur edhe mundësinë e përfaqësimit të Shqipërisë.

MKRS-ja vazhdon përkrahjen financiare për federatat dhe organizatat sportive

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka nënshkruar memorandume për mbështetje financiare vjetore për vitin 2025 me Komitetin Olimpik të Kosovës, Komitetin Paralimpik, Olimpiadën Speciale të Kosovës, Federatën e Xhudos, Mundjes, Boksit, Aeronautikës, Gjymnastikës, Muaythai, Federatën e Autosporteve, Kickbox, Bodybuilding, Federatën e Padelit, Pikados, Futbollit, Volejbollit, Sportit Shkollor, Shahut, Sportit Universitar, Boullingut, Esports, Golfi, Motociklizmit, Biliardos, Ragbit, Atletikës, Shenjëtarisë, Federatën e Sporteve për të Verbër, Federatën e Skitarisë, Badmingtonit, Kajakimit, Çiklizmit, Taekwondos, të Peshëngritjes dhe Federatën e Tenisit. “Zëvendësministria Daulina Osmani i njoftoi federatat prezente që sivjet është paraparë që çdo federatë ta ketë për obligim që së paku 30% të shumës totale të përfitimit t’ia dedikojnë aktiviteteve sportive për vajza dhe gra, me qëllim të zhvillimit dhe fuqizimit të mëtejme të sportit femëror në vend. Shuma totale për mbështetje të të gjitha federatave dhe organizatave sportive këtë vit është afër 8 milionë euro”, thuhet në njoftimin e MKRS-së.

11 vjet nga miqësorja historike Kosova - Haiti

PRISHTINË, 5 MARS - Miqësorja e konsideruar historike, në mes të Përfaqësueses së Kosovës dhe Haitit, e cila ishte takimi i parë ndërkombëtar nën monitorimin e FIFA-s, ndodhi më 5 mars 2014 dhe përfundoi me rezultat 0-0. Stadiumi Olimpik “Adem Jashari” në Mitrovicë, që kishte

marrë pamjen e një stadiumi evropian, ishte arena e përballjes së parë historike ndërkombëtare për “dardanët”. Mbi 17 mijë tifozë ishin të pranishëm në stadium për ta ndjekur këtë lojë historike, ndërkohë që aty nuk munguan edhe udhëheqësit kryesorë të shtetit të Kosovës, duke filluar

nga presidentja, kryeministri dhe kryeparlamentari. “Që atëherë futbolli ynë ka bërë hapa gjigantë përpara, si pjesë e UEFA-s dhe FIFA-s që nga maji i 2016-s, duke frymëzuar breza të rinj për t’i ndjekur ëndrrat e tyre. Një moment që ndryshoi gjithçka!”, shkruan Federata e Futbollit të Kosovës.



Simeone: Jemi gjallë, presim një natë të mirë në ndeshjen kthyesë

MADRID, 5 MARS - Atletico Madridi pësoi humbje 2-1 nga Real Madridi në ndeshjen e parë të fazës së 1/8-s së Ligës së Kampionëve. Trajneri Diego Simeone shprehu kënaqësinë për paraqitjen e bërë nga ekipi i tij, ndonëse ishte i zhgënjyer me mënyrën e golave të pësuar. “Ishte një ndeshje shumë taktike. Ne po përpiqeshim ta kalonim

secilin në momentet e tyre të ndryshme. Ata filluan më mirë, shënuan një gol të madh që ne mund ta zgjidhnim më mirë. Merita e madhe e skuadrës ishte që të mos dorëzohej, të mos hynte në atë frikën e fazës që gjeneron pranimin e një goli kaq herët. Përkundrazi, filluam të luanim, të futeshim në lojë, të merrnim kontrollin, të

futeshim në pjesën e kundërshtarit. Goli i Julianit erdhi, pasi Lino nuk mundi ta shtynte pasimin. Kështu përfundoi pjesa e parë që më dukej e kuptuar mirë”, ka thënë Simeone, duke shtuar: “Të dytën e nisëm njësoj. Erdhi loja e mrekullueshme e Brahimit që ne, gjithashtu, mund ta zgjidhnim më mirë dhe që përfundoi duke prishur

ekuilibrin. Kundërsulmi për ta ishte aty, me atë punë që e bëjnë shumë mirë Vini dhe Mbappe, të cilët i rikthehen punës. Ata kanë potencial të madh për kundërsulme”. Në fund trajneri Simeone shprehu optimizëm për ndeshjen kthyesë, por thotë se fillimisht duhet të fokusohen në ndeshjen e radhës ndaj Getafës. “Ne jemi gjallë dhe



mund të ndodhë që të mërkurën të kemi një natë të mirë. E kuptoj që ne fillimisht e kemi kokën te Getafe. Nga e diela mbrëma do të fillojmë të mendojmë për ndeshjen e dytë”, ka shtuar Simeone.

Le Bron Jamesi thyen një rekord të jashtëzakonshëm në NBA

LOS ANXELOS, 5 MARS - Le Bron Jamesi është bërë lojtari i parë në historinë e NBA-s që arrin 50 000 pikë të kombinuara, ndërsa ndihmoi Los Angeles Lakersin të triumfojë ndaj New Orleans Pelicansit. Amerikani 40-vjeçar e kaloi këtë shifër historike në fillim të çerekut të parë, gjatë fitores 136-115 te lakersat, duke marrë një pasim nga Luka Doncic dhe duke realizuar një treshe spektakolare nga 7.6 metra largësi. James, i cili është shënuesi më i mirë në historinë e NBA-s, e mbylli ndeshjen me 34 pikë, duke çuar totalin e karrierës së tij në 60 149 pikë, 6 000 më shumë se legjenda Kareem Abdul-Jabbar i cili renditet i dyti. Totali i pikëve të Jamesit përbëhet nga një rekord prej 41 871 pikësh në sezonin e rregullt, të cilave u shtohen 8 162 pikë në fazën “play-off”, ku ai është shënuesi më i mirë në histori. “Nuk do ta zbukuroj. Është një numër i jashtëzakonshëm pikësh”, ka thënë James. “Jam jashtëzakonisht i bekuar që kam



arritur të shënoj kaq shumë pikë në karrierën time, në ligën më të mirë në botë dhe kundër lojtarëve më të mirë në botë. Është diçka shumë e veçantë”. Le Bron Jamesi arriti këtë moment historik në sezonin e tij të 22-të, duke barazuar Vince Carterin për numrin më të madh të sezoneve të luajtura në NBA. Ai u ndihmua nga performanca e shkëlqyer e Luka Donqiqit, i cili shënoi 30 pikë, dha 15 asistime dhe kapi 8 kërcime, ndërsa lakersat regjistruan fitoren e shtatë radhazi, duke u ngjitur në vendin e dytë në Konferencën Perëndimore. Legjenda e

lakersave, Earvin “Magic” Johnson, ishte ndër të parët që e përgëzoi Jamesin për këtë arritje historike në rrjetet sociale. “Urime Mbretit Le Bron James për t’u bërë i vetmi lojtar në historinë e NBA-s që arrin 50 000 pikë të kombinuara në sezonin e rregullt dhe ‘play-off’!”, ka shkruar Johnsoni në X. Më herët gjatë së martës, Jamesi u shpall gjithashtu “Lojtari i Muajit” në Konferencën Perëndimore të NBA-s, pasi pati një mesatare prej 29.3 pikësh, 10.5 kërcime dhe 6.9 asistime muajin e kaluar, duke u bërë lojtari më i vjetër që e fiton këtë çmim.

Clevelandi siguron një vend në ‘play-off’, shkëlqejnë edhe lakersat, Milwaukee e Golden State

ÇIKAGO, 5 MARS - Vijon momenti i mirë në NBA për ekipin e lakersave, që mposhti me rezultat 136-115 New Orleansin, duke korrur suksesin e shtatë radhazi. Le Bron Jamesi me 34 pikë e Luka Donqiqi me 30 pikë e 15 asistime shkëlqyen për kalifornianët. Fitore në sekondat e fundit për Toronton, që mundi me rezultat 114-113 Orlandon, ndeshje ku u dallua RJ Barrett me 21 pikë, ndërsa 41 pikët e Paolo Banchero mbetën për statistikë. Skuadra e Phoenixit, falë 34 pikëve të Kevin Durantit, mposhti me rezultat 119-117 clippersat. Edhe Golden State po ngjiti shkallët në renditje, duke mposhtur me rezultat 114-102 New Yorkin.



Stephen Curry me 28 pikë ishte lider për Warriorsin. Jashtë fushës triumfoi edhe Milwaukee, që mundi me rezultat 127-121 Atlantan. Antetokounmpo realizoi një “triple-double”, me 26 pikë, 12 rebounde e 10 asistime. Clevelandi bëhet skuadra e parë

REZULTATET		
Indiana - Houston		115-102
Orlando - Toronto		113-114
Atlanta - Milwaukee		121-127
New York - Golden State		102-114
Chicago - Cleveland		117-139
Minnesota - Philadelphia		126-112
San Antonio - Brooklyn		127-113
Phoenix - Clippers		119-117

që siguron një vend në “play-off”, duke mundur me rezultat 139-117 Chicagon. Donovan Mitchell me 28 pikë e Jarrett Allen me 25 pikë ishin liderë në fushë. Minnesota mposhti me rezultat 126-112 Philadelphian, me shtatë lojtarë që realizuan mbi 10 pikë.

SHKURT

Istogu fiton derbin në Samadrexhë

Kampioni në fuqi, Istogu, është shkëputur në tabelën e Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Istogu e fitoi derbin e xhiros së 11-të ndaj Samadrexhës. Ndeshja në palestrën “Afrim Bunjaku” në Samadrexhë përfundoi me fitoren 32:30 të istogaseve. Ndeshja ishte e fortë, ndërsa u zhvillua para rreth 500 shikuesve, në një ambient të bukur sportiv. Në pjesën e parë mysafiret kishin epërsi pas minutës së 15-të, por vendaset qëndruan pranë në rezultat. Në minutën e 44-t Samadrexha ia doli të barazojë në 22:22, por pasoi një seri 3:0 e Istogut për 25:22. Më Samadrexha nuk ia doli të afrohet. Astou Ndiaye udhëhoqi Istogun duke i shënuar plot 12 gola. Dhjetë i realizoi Lana Paviçević. Te vendaset shkëlqeu Arlinda Maloku me plot 13 gola dhe efikasitet shumë të lartë. Gjashtë gola i shënoi Jennifer Amanda Toldeo Abreu, ndërsa pesë i kishte Tina Hetemi. Istogu tani udhëheq me 18 pikë, dy më shumë se Ferizaj. Samadrexha është e pesta me 10 pikë.

Mitaj, gati për Shqipërinë

Selektori i Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho, ka marrë një lajm të mirë në prag të grumbullimit të këtij muaji për kualifikimet e Botërorit 2026. Mbrojtësi i krahut të majtë, Mario Mitaj është rikthyer në stërvitje tek Al-Ittihadi dhe do të jetë i gatshëm për lojë në vikend. Mitaj ishte lënduar javë më parë dhe ekipit nga Arabia Saudite i mungoi në 5 ndeshjet e fundit kampionale. Megjithatë, ai tashmë do të jetë i gatshëm për lojë dhe pritet të ftohet nga Sylvinho për ndeshjet me Anglinë dhe Andorrën, të cilat Shqipëria i luan në kuadër të kualifikimeve për Kupën e Botës 2026. Rikthimi i Mitajt nga lëndimi është një lajm i mirë për Sylvinhon, i cili po shpreson që për ndeshjet e këtij muaji ta ketë në dispozicion edhe Ardian Ismajlin e Empolit.

Anelotti: Morëm një avantazh të lehtë ndaj Athleticos

Trajneri Carlo Ancelotti ka thënë se Real Madridi mori një avantazh të lehtë ndaj Atletico Madridit (2-1) në ndeshjen e parë të Ligës së Kampionëve. “Ishte një ndeshje e ekuilibruar, me shumë intensitet. E kontrolluam mirë në nivel defensivë, por mund të bënim më shumë pas golit të avantazhit. Objektivi ishte të merrnin një avantazh të lehtë dhe ia arritëm. Mbappe? Nuk ishte në nivelin e tij maksimal, por edhe ai bëri një punë të mirë. Nuk ishte e lehtë të luaje kundër një mbrojtje të mbyllur si e Athleticos. Një punë të shkëlqyer bëri edhe Rodrygo. Është një lojtar fantastik”, u shpreh Ancelotti. Golat për Realin i shënuan Rodrygo dhe Diaz, kurse për Atleticon golin e vetëm e shënoi Alvarez.

Vasseur, optimist për Ferrarin: Presim me padurim garën e parë

Pas testeve të kryera gjatë javës së kaluar, në Formula 1 ka filluar numërimi mbrapsht për sa i përket fillimit të sezonit të ri. Gara e parë sezonale është më 16 mars në pistën e Melburnit

në Australi. Pothuajse të gjithë kanë konfirmuar se McLareni është në “pole position” për fillimin e kampionatit, me Ferrarin që ndjek ekipin britanik, ashtu sikurse ndodhi

në Kampionatin Botëror të Konstruktorëve 2024. Gjithsesi, Frederic Vasseur, drejtori sportiv i “kokëkuqes”, shpreson në një rezultat ndryshe. Ai foli për sezonin që pritet të nisë:

“Ndjesia është pozitive, të paktën pas asaj që mund të përjetonim në testet në Bahrein. Tani vetëm presim të nisemi për në Australi ku do të kemi reagimet e para. Do të jetë

një sezon interesant, pasi diferencat janë të vogla dhe makina që do të përshtatet më mirë me pistën do të ketë një avantazh për ta fituar garën”, ka thënë Vasseur.



Në bazë të kompetencave të dhëna sipas nenit 21 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 13 të Ligjit nr.04/L111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bazuar në Ligjin nr. 03/L-212 të Punës dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, në bazë të Rregullores nr.04/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në NPK “Trafiku Urban” ShA. Prishtinë dhe në bazë të vendimit nr.767, 368 dhe 369 dt.05.03.2025, Bordi i Drejtorëve me datë 05.03.2025 shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

- Shpallet konkurs publik për kohë të caktuar për vendin e punës në ndërmarrje si në vijim:
- **Pozita e punës:** Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit- ZKFTH (1 pozitë)
- **I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve
- **Kohëzgjatja e punës:** 3 vite
- **Niveli i Pagës:** II

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron që çdo kandidat për Zyrtar Kryesor Financiar dhe Thesarit- ZKFTH duhet të ketë integritet të lartë i cili i plotëson kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale në bazë të nenit 17 të Ligjit nr.03/-087 për ndërmarrjet Publike në lidhshmëri me nenin 13 të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidati duhet të ketë:

- Përgatitje Universitare - Fakulteti Ekonomik
- 5 vite punë profesionale nga fusha e Financave dhe Kontabilitetit.
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks të veçantë në Ligjin për NP, Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- Të ketë aftësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
- Shkathtësi të dëshmuara në punë me grupe dhe organizim të ndërmarrjes apo të ngjashme;
- Shkathtësi të mira në punën me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përpilon planin buxhetor dhe kërkesën për ndarje buxhetore të ndërmarrjes;
- Përpilon planin financiar të Ndërmarrjes, raportet mujore, tremujore dhe vjetore brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike;
- Siguron që të gjitha faturat e rregullta të pranua në ndërmarrje të regjistroheshin dhe të ekzekutohen brenda afatit ligjor;
- Është përgjegjës për zbatimin e të gjitha dispozitave financiare dhe standardeve të kontabilitetit, ligjet e aplikueshme në Kosovë, të cilat rregullojnë çështjet financiare dhe aktet normative të ndërmarrjes;
- Organizon, udhëheq dhe kontrollon punën e departamentit financiar;
- Mban evidencë dhe dokumentacion të saktë për investimet dhe pagesat e ndërmarrjes;
- Përcjell gjendjen financiare në arkë dhe banka dhe bashkëpunon me institucionet bankare dhe organet tjera në interes të ndërmarrjes;
- Është përgjegjës për përgatitjen e transfereve bankare përkatësisht pagesave me dokumentacion mbështetës dhe siguron KE-në se pagesa është në rregull;
- Harton, zbaton dhe kontrollon zbatimin e procedurave financiare nga vartësit;
- Është përgjegjës të kontrollojë mbajtjen në rregull të arkivit të dokumentacionit të kontabilitetit dhe atij financiar;
- Zhvillon dhe zbaton rregullat e brendshme të kontrollit si dhe udhëzimet dhe procedurat për aktivitete si administrimi i buxhetit, menaxhimi i pasurive dhe detyrimeve dhe mbajtja e llogarive;
- Është përgjegjës për rregullsinë e proceseve në funksionin e kontabilitetit në kompani, përgatit dhe zbaton procedurat e kontabilitetit sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, si dhe me kompetencë menaxhon resurset financiare të kompanisë brenda ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Bashkëpunon me Auditorët e ndërmarrjes dhe zbaton rekomandimet të cilat vijnë si rrjedhojë e një auditimi të brendshëm, të jashtëm ose nga çfarëdo organi tjetër këshillues apo ofrues i sigurisë;
- Ushtron kujdes për ecurinë e shpenzimeve të Ndërmarrjes sipas planit të biznesit, pagesën e obligimeve Ligjore dhe afarizmin e Ndërmarrjes;
- Bashkëpunon me zyrtarët tjerë të Ndërmarrjes siç janë: Kryeshefi Ekzekutiv, Auditori i Brendshëm dhe Sekretari për të ndihmuar ndërmarrjen në arritjen e objektivave të saj;
- Kryen edhe punë të tjera, për të cilat autorizohet nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Bordi Mbikëqyrës.
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Bordit të Drejtorëve,

Dokumentacioni i kërkuar:

- Kandidati duhet t'i dorëzojë dokumente në formë fizike në zyrën nr.5 të Trafikut Urban vetëm në zarfë të mbyllur për Bordin e Drejtorëve;
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com> në vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë.
- Një CV të detajuar;
- Dëshmi mbi shkollimi, kopjet e diplomave mbi kualifikimin, diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Letër motivimin;
- Kopje të certifikatave;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Deklaratën nën betim;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij, jo më të vjetër se 6 muaj.

Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm në formë fizike në zyrën nr.5 të Trafikut Urban.
Konkursi është i hapur nga data **06.03.2025** dhe përfundon më datë **04.04.2025** në ora **16:00**.
Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.
Datë:05.03.2025

NPK “ Trafiku Urban” SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në bazë të kompetencave të dhëna sipas nenit 21 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 13 të Ligjit nr.04/L111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bazuar në Ligjin nr. 03/L-212 të Punës dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, në bazë të Rregullores nr.04/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në NPK “Trafiku Urban” ShA. Prishtinë dhe në bazë të vendimit nr.767, 368 dhe 369 dt.05.03.2025, Bordi i Drejtorëve me datë 05.03.2025 shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

- Shpallet konkurs publik për kohë të caktuar për vendin e punës në ndërmarrje si në vijim:
- **Pozita e punës:** Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv (1 pozitë);
- **I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve
- **Kohëzgjatja e punës:** 3 vite
- **Niveli i Pagës:** II

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron që çdo kandidat për Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv duhet të ketë integritet të lartë i cili i plotëson kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale në bazë të nenit 17 të Ligjit nr.03/-087 për ndërmarrjet Publike në lidhshmëri me nenin 13 të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidati duhet të ketë:

- Diplomë Universitare, sikur që duhet të përmbushë kushtet sipas legjislacionit në fuqi;
- Së paku 5 vite përvojë pune në nivele të larta menaxheriale;
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks të veçantë në Ligjin për NP, Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- Të ketë aftësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
- Shkathtësi të dëshmuara në punë me grupe dhe organizim të ndërmarrjes apo të ngjashme;
- Shkathtësi të mira në punën me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes ka autoritet që të kryej të gjitha punët dhe detyrat që i janë përshkruar Kryeshefi Ekzekutiv me delegim nga KE apo BD.
- Zëvendës Kryeshefi Ekzekutiv vepron si zëvendësues i zyrtarit kryesor administrativ të ndërmarrjes;
- Drejtpërdrejtë ndihmon Kryeshefin Ekzekutiv në: Organizimin e Ndërmarrjes, në pajtueshmëri me statutin dhe aktet tjera të ndërmarrjes dhe vendimet e Bordit të Drejtorëve;
- Në të gjitha çështjet në lidhje me ndërmarrjen të cilat nuk janë përgjegjësi e Komisionit Komunal të Aksionareve, Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit/Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm, do të vendosen me përgjegjësitë e Kryeshefit Ekzekutiv;
- Bashkëpunon me Bordin e Drejtorëve, në përcaktimin e strategjisë së ndërmarrjes dhe planet e saja strategjike afatgjata;
- Ofron kurdo që të jetë e nevojshme dhe së paku një herë në muaj, Bordit të drejtorëve raporte për transaksionet kryesore të ndërmarrja nga ndërmarrja dhe për vendimet kryesore të marra nga menaxhmenti lidhur me udhëheqjen e veprimtarisë së ndërmarrjes;
- Bordit të Drejtorëve i dorëzon dokumente, shkresa dhe informacione lidhur me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij;
- Ofron Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet;
- Ofron Zyrtarit të Auditimit të brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohen nga ai;
- Merr pjesë në të gjitha mbledhjet e përgjithshme;
- Kryen detyra dhe punë të tjera të caktuara nga Bordi i Drejtorëve në pajtim me legjislacionin në fuqi si dhe punë e detyra të deleguara nga KE.
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Bordit të Drejtorëve,

Dokumentacioni i kërkuar:

- Kandidati duhet t'i dorëzojë dokumente në formë fizike në zyrën nr.5 të Trafikut Urban vetëm në zarfë të mbyllur për Bordit të Drejtorëve;
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com> në vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë.
- Një CV të detajuar;
- Dëshmi mbi shkollimi, kopjet e diplomave mbi kualifikimin, diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Letër motivimin;
- Kopje të certifikatave;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Deklaratën nën betim;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij, jo më të vjetër se 6 muaj.

Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm në formë fizike në zyrën nr.5 të Trafikut Urban.
Konkursi është i hapur nga data **06.03.2025** dhe përfundon më datë **04.04.2025** në ora **16:00**.
Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.
Data: 05.03.2025

NPK “ Trafiku Urban” SHA
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë
web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Në bazë të kompetencave të dhëna sipas nenit 21 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 13 të Ligjit nr.04/L111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bazuar në Ligjin nr. 03/L-212 të Punës dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, në bazë të Rregullores nr.04/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në NPK “Trafiku Urban” ShA. Prishtinë dhe në bazë të vendimit nr.767, 368 dhe 369 dt.05.03.2025, Bordi i Drejtorëve me datë 05.03.2025 shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

- Shpallet konkurs publik për kohë të caktuar për vendin e punës në ndërmarrje si në vijim:
- Pozita e punës:** Këshilltar i Përgjithshëm / Sekretar Korporativ (1 pozitë);

- I përgjigjet:** Bordit të Drejtorëve
- Kohëzgjatja e punës:** 3 vite
- Niveli i Pagës:** II

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve dëshiron që çdo kandidat për Këshilltar i Përgjithshëm / Sekretar Korporativ duhet të ketë integritet të lartë i cili i plotëson kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale në bazë të nenit 17 të Ligjit nr.03/-087 për ndërmarrjet Publike në lidhshmëri me nenin 13 të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidati duhet të ketë:

- Diplomë Universitare në Fakultetin Juridik;
- 5 vite përvoj pune profesionale;
- Njohja e mirë e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, me theks të veçantë në Ligjin për NP, Ligjin për Shoqëritë Tregtare;
- Të ketë aftësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
- Shkathtësi të dëshmuara në punë me grupe dhe organizim të ndërmarrjes apo të ngjashme;
- Shkathtësi të mira në punën me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të gjitha detyrat në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike të përcaktuara për Këshilltar i Përgjithshëm / Sekretar Korporativ;
- Procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, komiteteve të Bordit dhe aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
- Koordinon punën e Bordit të drejtorëve me menaxhmentin dhe Komisionin Komunal të Aksionarëve;
- Jep këshilla Bordit të Drejtorëve sipas kërkesës;
- Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkojnë sipas ligjit të regjistrohen në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtar;
- Sekretari do të mbaj procesverbalin e secilës Mbledhje të Përgjithshme të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit dhe të shpërndajë ato procesverbale tek drejtorët e bordit;
- Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit të Korporatës përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit të Korporatës duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëherit është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
- Si dhe detyrat tjera të cilat (më tutje) mund të jenë të përshkruara në përshkrimin e bashkangjitur të punës ose të caktuara nga punëdhënësi;
- Për BD bën matjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve përmes Departamentit përkatës i cili vepron nën përgjegjësinë e ti. Për shkak të specifikave dhe numrit shumë të madhë të Konsumatorëve raportet përgatiten rregullisht për BD së paku çdo tre muaj duke nxjerrur raporte kredibile duke krahasuar performancën e Ndërmarrjes, ndaj klientëve të saj ;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Bordit të Drejtorëve.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Kandidati duhet t'i dorëzoj dokumente në formë fizike në zyrën nr.5 të Trafikut Urban vetëm në zarfë të mbyllur për Bordit të Drejtorëve;
- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com> në vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë.
- Një CV të detajuar;
- Dëshmi mbi shkollimi, kopjet e diplomave mbi kualifikimin, diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Letër motivimin;
- Kopje të certifikatave;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të dëshmuar me Trust;
- Deklaratën nën betim;
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij, jo më të vjetër se 6 muaj.

Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material i nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm në formë fizike në zyrën nr.5 të Trafikut Urban. Konkursi është i hapur nga data **06.03.2025** dhe përfundon më datë **04.04.2025** në ora **16:00**. **Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.
Data: 05.03.2025



Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ambianti” Sh.A .Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFFT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regjionale të Mbeturinave “Ambianti” Sh.A .Pejë me datë 04.03.2025, shpall konkurs të brendshëm për këto vende të punës :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita : Kontroller i brendshëm (inspektor) - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.
Koeficienti i pagës : 2.5

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësiave të punës:

- Obligohet që në terren të sillet korrekt dhe të mbaj uniformë dhe shenjë identifikimi të Ndërmarrjes;
- Në baza ditore nxjerr nga CRM-ja ankesat që janë dërguar për inspektim, angazhohet drejtpërdrejt me rastin e zgjedhjes së ankesave dhe është përgjegjës për dhënien e shënimeve të duhura për zgjidhjen e këtyre kontesteve në afat sa më të shpejt;
- Regjistron në CRM, të gjitha proqeset që i ka inspektuar sipas rregullores së punës;
- Jep përgjegjësi për mos kryerjen e ankesave që i janë deleguar sipas CRM-së;
- Sipas planit mujor të kontablistit bën inspektimin, monitorimin dhe rishikimin e aktiviteteve të inkasantëve në terren se a është bërë dorëzimi i faturave të konsumatorët dhe kontrollon se a janë të gjitha faturat në rregull;
- Në bazë të kontrollimit të gjendjes reale dhe te të gjeturave në terren, raporton tek kontablisti me shkrim të protokoluar më numër personal dhe datë;
- Raporton punën ditore, mujore dhe vjetore tek kontablisti;
- Detyrohet të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
- Kryen edhe punë të tjera operative me urdhëresë të kontablistit dhe ZKF-së;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :{kualifikimet profesionale}

- Shkollë c Mesme, e preferuar Diplomë Universitare;
- Njohja e punës me kompjuter;
- Aftësia të mira komunikimi ;
- 1 vit përvojë pune e dëshmuar ;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 04.03.2025 deri me 19.03.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Deshire Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Ismet Berisha nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u “Hamëz Cena” Damjan KK Gjakovë nga kl. 1-8.

- Egzon Berisha nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan KK Gjakovë nga kl. 1 -8.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

